



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:223290  
Datë: 09.06.2022  
Numri i dokumentit: 03115740

**K.nr.993/21**

**Gjykata Themelore Gjilan, - Divizioni i Kundervajtjes** sipas gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa, duke vendosur në lëndën kundërvajtëse kundër të pandehurit I.Xh nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **210 par.3** lidhur me nenin 255 paragrafi 2, të LRRTRR nr.05/L-088, e në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 77, 86, 87, 119 dhe 124 të Ligjit mbi Kundervajtjet, me datën **09.06.2022**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Kundër të pandehurit I. Xh, nga babai M..., i lindur me ... jeton në Gjilan rr.”...” nr.14, i martuar, pensioner, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse me datën **12.09.2021**, aty rreth orës **12:00** min, me automjetin e llojit “**Volkswagen Jetta**” me targa ..., ka shkaktuar aksident komunikacioni në atë mënyrë që në rr.”Lidhja e Prizrenit” në drejtim të qytetit të Gjilanit, më sakt përball sallonit të mobilerisë “MobiCasa” në Gjilan ka shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale duke e goditur nga mbrapa motorin elektrik në lëvizje në të njejtin drejtim që kishte qenë duke e ngasur i dëmtuari E. D nga Gjilani, kundërvajtësi vazhdon të lëvizë me veturën e tij pa u ndalur, në ato momente i dëmtuari E. D e godet me këmbë në rrotë veturën e ankuesit që ai të ndalet, pastaj kundërvajtësi ndalet me veturë në vendin e aksidentit, i ndërrojnë disa fjalë fyese me të dëmtuarin, më pas kundërvajtësi e nxjerr nga bagazhi i veturës së tij mbrapa një lloz të drurit dhe e godet disa herë motorin e aksidentuar të të dëmtuarin E.D dhe largohet nga vendi i aksidentit. Me këtë rast-aksident motorri elektrik i të dëmtuarit Edi Demi kishte pësuar dëme materiale në anën e pasme dhe në dy pasqyret anash.

- Si pasoje shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale,

- Me ç’veprim ka kryer veprën kundërvajtëse të paraparë dhe të sanksionuar me dispozitat e nenit **210.par 3** lidhur me nenin 255 p.2 të LRRTRR nr. 05/L-088, të Kuvendit të Kosovës, andaj

## D Ë N O H E T

**ME DËNIM-GJOBË në shumë prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore, t'i paguaj kësaj Gjykate shumën prej **5 €**, në afat të njëjtë sikurse gjobën.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.  
Nga një kopje e aktgjykimi t'iu dorëzohet palëve në procedurë.

## A r s y e t i m

**Trafiku Rajonal në Gjilan, -** ka parashtruar kërkesën me nr. **2021-CA-...** me datën **12.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartëshenuar për veprën kundërvajtëse të parashikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme.

Gjyqtari me qëllim të vertetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ftoi të pandehurin më ftesë, për të dhënë mbrojtjen e tij, i cili e pohoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë duke deklaruar se vërtetë se me datën **12.09.2021** në ora **12:00** h, vërtetë në rrugën "Lidhja e Prizrenit" përball mobilerisë "Mobi Casa" në Gjilan, është involvuar në aksident komunikacioni pa qëllim, pa dashje dhe vërtetë me këtë rast nga mllefi ishte irrituar me rastin e aksidentit dhe është dalur nga vetura dhe vërtetë e kishte marrur një mjet druri në kipek, pasi që e kishte blerë për bisht të sopatës dhe nga irritimi nuk ka mundur ta kontrolloj veten me këtë rast dhe vërtetë i ka mëshuar motoçikletës disa herë dhe nuk mund ta dij se në cilën pjesë, duke theksuar se e ka dëmtuar ndoshta pak dhe nga ky irritim nuk është ndalur në vendin e ngjarjes dhe ka vazhduar të lëviz nga vendi i ngjarjes.

I njëjti ka deklaruar së me kalimin e kohës vërtetë është penduar për këto veprime të bëra të cilat me vetdije dhe qëllimisht nuk do ti kishte bërë por këto kanë ardhur si rrjedhojë nga aksidenti i shkaktuar. Andaj edhe është i penduar thellë për këtë rast që ka ndodhur dhe është person i shtyrë në moshë prej 74 viteve duke theksuar se është hera e parë në jetën e tij që i ka ndodhur një veprim i tillë dhe hera e parë që ballafaqohet me ligjin andaj, lut gjykatën që mundësisht kësaj here ti mer parasysht këto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendosjes t'i shqiptoj një dënim sa më të vogël minimal.

Gjyqtari me qëllim të vertetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike mori në pyetje edhe të dëmtuarin në këtë aksident E. D i cili në seancën gjyqësore të mbajtur ka deklaruar se në këtë aksident nuk ka lëndime trupore vetëm me dëme materiale në motoçikletë dhe deklaron se e ka

realizuar kompensimin për dëmin material dhe në të ardhmen nuk paraqet kurfar problemi për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit.

Gjyqtari pas shiqimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit dhe të dëmtuarit, fotove mbi vendin e ngjarjes së aksidentit, shkresave tjera në lëndë, me kujdes bëri shtjellimin e të gjitha provave të ofruara në lëndë dhe erdhi në përfundim të plotë, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet dhe provat e mjaftueshme se i pandehuri është përgjegjës për veprën kundërvajtëse e cila i veheet në barrë, vepër kjo e paraparë dhe e sanksionuar me dispozitat e nenit **210 par.3** lidhur me nenin 255 par.2 të LRRTRR, kështu që të pandehurin e dënoi me denim gjobe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë matjes së dënimit, gjyqtari pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat objektive dhe subjektive në të cilën është kryer kundërvajtja, rrezikshmërinë shoqërore dhe kështu që në vështrim të nenit 31 pika 1 të LMK-së, mori parasysh të gjitha këto si rrethana lehtësuese dhe rënduese dhe të pandehurin e ndëshkoi me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit 35 të LMK-së, duke konsideruar se edhe me një lloj të tillë të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të përsërisë kundërvajtje të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore është marrë në bazë të nenit 59 par 1, të LMK-së.  
Nga të cekurat e më sipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm  
Divizioni i Kundërvajtjes  
Me dt.09.06.2022**

**Zyrtarja ligjore,  
Erzë Mustafa**

**Gjyqtari,  
Menderes Behluli**

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit aktgjykim dhe atë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.